

## **R A P O R T**

### **I Bordit Mbikqyrës (BM) të Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni**

*23.03.2017, Shkup*

Në përputhshmëri me kompetencat dhe Rregulloren e Punës së Bordit Mbikqyrës të Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni, anëtarët e këtij trupi përgatitën raportin si në vijim, me konstatime për punën e tyre dhe punën e KEMM-it për vitin 2016, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi i KEMM-it.

Anëtarët e Bordit Mbikqyrës e pranuan raportin për punën finansiare-materiale të KEMM-it për periudhën në fjalë, me disa vërejtje, propozime e sugjerime.

Bordi Mbikqyrës jep mbështetje të plotë për punën e Zyrës Ekzekutive, për sigurimin e mjeteve përmes donatorëve të huaj në bazë të projekteve. Megjithatë, duke pasur parasysh se 100% e të ardhurave sigurohen nga donacionet, është e domosdoshme që KEMM-i të hartojë një plan për vetëqëndrueshmëri në të ardhmen, sidomos përmes të ardhurave nga anëtarësimi. ***Edhe pse, nëse shikohet gjendja aktuale me mediat, ajo që për momentin duket mision vështirë i realizueshëm, megjithatë, duke marr parasysh se bëhet fjalë për një praktikë e cila është bazë e funksionimit të trupave vetërregullues në shoqëritë demokratike, është e nevojshme që të punohet në atë drejtim. Deri atëherë, kjo ngel një nga qëllimet primare të Zyrës Ekzekutive të KEMM-it, që të jetë – sigurim i hershëm i finansimit të qëndrueshëm përmes donacioneve të fituara në bazë të projekteve.***

Mënyra e shpenzimit të mjeteve të donatorëve të huaj është e dedikuar, siç është përcaktuar edhe me projektet, ndërsa donatorët i vlerësojnë në mënyrë pozitive rezultatet e zbatuara deri më tani, si dhe projektet aktuale. Më pas, janë dhënë sinjale për mundësi për mbështetje të mëtutjeshme, me qëllim që të përforcohen kapacitetet e këtij trupi për vetërregullim në media, në fazën fillestare të punës dhe zhvillimit të tij.

Bordi Mbikqyrës, gjithashtu vlerëson si pozitiv faktin që të gjitha pagesat, gjegjësisht, poshtuajse 98%, janë të bëra në mënyra elektronike, që është një motiv shtesë për anëtarësimin e Bordit Mbikqyrës që të deklarohet pozitivisht ndaj Raportit për punën finansiare-materiale të KEMM-it.

Përshëndeten përpjekjet e Zyrës Ekzekutive dhe të udhëheqësisë së KEMM-it për angazhimin e tyre rreth sigurimit të projekteve dhe etablimin të mëtejshëm të organizatës tek opioni i gjërë. KEMM-i përforcoi bashkëpunimin e tij edhe me një numër më të madh partnerësh, si në suaza kombëtare ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Vëçanërisht përshëndetet bashkëpunimi i rregullt dhe i dobishëm me AIPCE (Aleanca për këshilla të pavarur për etikë në Evropë) dhe me rrjetin rajonal të këshillave për etikë në rajonin e Ballkanit, MediaNethics, prej ku merr mbështetje të konsiderueshme dhe rekomandime rreth zhvillimit në funksionimin e organizatës. Në të njëjtën kohë, përshëndetet edhe fakti që raportet e deritanishme ndaj donatorëve (Ambasada Holandeze, UNESCO, Agjencia Zviceriane për Zhvillim Ndërkombëtar) janë vlerësuar pozitivisht dhe janë pranuar plotësisht dhe që sigurohen apo paralajmërohen mbështetje edhe për funksionimin dhe aktivitetet e mëtejshme të KEMM-it.

Nga shqyrtimi i raporteve të deritanishme financiare, Bordi Mbikëqyrës konkludoi se Zyra Ekzekutive ka vepruar me mjetet e KEMM-it në drejtim të funksionimit sa më të suksesshëm të organizatës. Edhe nga raporti i fundit nuk janë vërejtur kategori për të cilat mund të konstatohet se ka keqpërdorim të pozitës dhe autorizimeve, ose që janë bërë shpenzime jashtë detyrimeve të përcaktuara.

## V Ë R E J T J E

1. Në periudhën për të cilën raportohet është konstatuar se numri i personave me punësim të përhershëm, të cilët janë pjesë e Zyrës Ekzekutive, është i vogël dhe është e domosdoshme që ky numër të zgjerohet për shkak të vëllimit të punës. Rekomandimi i BM është që të gjendet mënyra dhe mjetet për të zmadhuar numrin e të punësuarve të përhershëm, në pajtueshmëri me vëllimin e punës në Zyrën Ekzekutive, më konkretisht me më së paku edhe dy persona, në pjesën e punës teknike-administrative dhe menaxhimit financiar të organizatës.
2. Së bashku me raportin të bashkëngjitet edhe pjesa financiare për punën materiale-financiare.

*Shkup, 23.03.2017,*

Kryetar i Bordit Mbykqyrës,

---

*Zoran Fidanoski*